



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISHTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

AD/GJTHPR/19/23

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. SH.B, në cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse S.K, ndaj gjyqtarës Sh.V, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 11.01.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga av. SH.B në cilësinë e përfaqësuesit të palës paditëse S.K, ndaj gjyqtarës Sh.V, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Av. SH.B me datë 18 Dhjetor 2023 përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarës Sh.V, me kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Me datë 19.12.2023 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës.

Parashtruesi i ankesës av. SH.B në ankesën e tij ka deklaruar se paditësi ka ushtruar padi për mos përmbushje të kontratës kundër të paditurit M.R nga Gjakova, lëndë kjo e evidentuar me shenjë C.nr.2050/14. Sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtari paraprak i cili ka qenë i ngarkuar me lëndën A.T, ka filluar shqyrtimin e saj ku me datë 19.10.2020 ka vendosur që të paditurit ti caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, ku Oda e Avokatëve ka caktuar avokatin A.B nga Prishtina. Sipas tij, nga data 04.11.2020 kur me parashtrësë e kanë dorëzuar aktvendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të përkthyer në gjuhën angleze sipas kërkesës së gjykatës, nuk është ndërmarrë asnjë veprim, duke bërë kështu që të kalojnë plot 3 vite. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka deklaruar se pasi që ka kuptuar se tashmë gjyqtari paraprak A.T ka kaluar në një gjykatë tjetër, është njoftuar se lënda ka kaluar te gjyqtarja Sh.V, me të cilën ka tentuar të bisedoj por që e njëjta nuk e ka dëgjuar dhe e ka larguar nga zyra. Sipas tij, ka dërguar parashtrësë të ndryshme te gjyqtarja dhe te Kryetarja e Gjykatës, por nuk ka pranuar përgjigje.

Në lidhje me pretendimet e paraqitura në ankesën disiplinore, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se përfaqësuesi i paditësit S.K nga Prishtina, avokati SH.B nga Prishtina, me ankesën e paraqitur ka theksuar se gjyqtari paraprak A.T në këtë lëndë ka ndërmarrë disa veprime juridike, gjë e cila nuk është kontestuese, por që të njëjtat veprime nuk kanë përfunduar dhe kanë mangësi. Sipas të njëjtës, nga emërimi i saj si gjyqtare, ka pranuar një numër të madh të lëndëve kontestimore të natyrave të ndryshme dhe i është çasur zgjedhjes së tyre sipas Planit strategjik, për zgjidhjen e atyre lëndëve. Përpos kësaj duke qenë se ka një fluks të madh të kuadrove gjyqësore, në mes të departamenteve të kësaj gjykate, por dhe një numër i tyre që kanë kaluar dhe në gjykatën Komerciale dhe në Gjykatën e Apelit, po kështu është ngarkuar me të gjitha ato lëndë të vjetra duke filluar nga viti 2006 etj, masave të sigurimit, të lëndëve në rigjykime si dhe urgjenca tjera. Duke qenë se kemi të bëjmë me numër të madh të lëndëve të vjetra, juridikisht dhe realisht sipas saj është e pamundur që të gjitha të zgjidhen në kohë të arsyeshme apo përnjëherë. Gjyqtarja e çështjes ndër të tjera ka deklaruar se Lëndën C.nr.2050/14 e ka pranuar nga gjyqtari paraprak A.T në muajin gusht të vitit 2022, dhe se sipas Planit Strategjik, e njëjta lëndë nuk i përmbush kriteret juridike për caktimin dhe vendimmarrjen e kësaj çështje juridike, sepse e njëjta është në fazën e trajtimit të lëndëve pronësore më të vjetra e se kjo lëndë, konkretisht të vitit 2011 dhe 2012. Në fund, gjyqtarja ka deklaruar se do të bëjë përpjekje që të ndërmerren veprimet e nevojshme për t'i evituar ato të meta proceduralo- juridike deri me tani që janë ndërmarrë, në mënyrë që pas evitimit të mangësive, duke përmbushur kushtet ligjore sipas dispozitës së nenit 81 par.2 dhe nenin 83 të LPK-së, gjykata të mund të procedoj dhe vendos në këtë çështje juridike në pajtim me Planin strategjik të KGJK-së.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës Sh.V.

Nuk është kontestues fakti se padia për mos përmbushje të kontratës është paraqitur me datë 22.07.2014 dhe kanë kaluar rreth 10 vite. Po ashtu, nuk është as kontestuese fakti se gjyqtari paraprak ka ndërmarrë veprime juridike, duke filluar kështu trajtimin e lëndës.

Nga të gjeturat rezulton se gjyqtarja e çështjes Sh.V është e ngarkuar me rreth 1200 lëndë, duke filluar nga viti 2004 e tutje. Ndërsa, janë rreth 50 lëndë të cilat janë të pranuar dhe të regjistruara më herët se lënda C.nr.2050/14, me kontest të njëjtë a po të ndryshëm. Duke marrë parasysh se gjyqtarja e çështjes ka ende lëndë të pa trajtuara të viteve paraprake por edhe lëndë të cilat duhet të trajtohen me prioritet, nuk ka mundur deri më sot të lëshohet në caktimin dhe trajtimin e kësaj lënde, kjo sepse gjyqtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë veprojnë në bazë të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2022-2025 i miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si dhe Opinioneve të Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të cilët përmes planeve strategjike dhe opinioneve kanë përcaktuar kontestet të cilat duhet të trajtohen me prioritet nga gjyqtarët, ku lënda me kontest **mos përmbushje e kontratës** nuk bënë pjesë në lëndët për të cilat kërkohet trajtim urgjent. Këto plane kanë paraparë detyrimin e gjyqtarëve që të gjitha lëndët të cilat sipas ligjit dhe planeve strategjike nuk konsiderohen si lëndë për trajtim me prioritet, të caktohen dhe trajtohen në bazë të radhës së pranimit dhe regjistrimit të tyre në gjykatë.

Është evidente se gjyqtari paraprak është lëshuar në caktimin dhe trajtimin e kësaj lënde dhe ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm, mirëpo pas pranimit të kësaj lënde në vitin 2022 nga gjyqtari paraprak, gjyqtarja Sh.V ka konstatuar se ka lëndë më të vjetra për shqyrtim se lënda në fjalë, andaj e njëjta ka vazhduar trajtimin e lëndëve sipas radhës së pranimit të tyre në gjykatë.

Autoriteti Kompetent duke parë ngarkesën e gjyqtares me lëndë dhe pas vlerësimit të regjistrave të punës së gjyqtares, ka gjet se deri te zvarritja e procedimit të kësaj lënde nga gjyqtarja ka ardhur si pasojë e ngarkesës me lëndë e jo për shkak se gjyqtarja me veprimet apo mosveprimet e saj po ndikon qëllimshëm në zvarritje. Mos caktimi i seancës gjyqësore për trajtim dhe vendosje të kësaj lënde ka ndodhur për shkak të faktorit objektiv, numrit të madh të lëndëve të cilat i ka pranuar nga gjyqtarja për shkak të lëvizjeve të mëdha të gjyqtarëve në kohën e fundit, edhe në përgjithësi numri i madh i lëndëve në konteste të ndryshme me të cilin ballafaqohen gjyqtarët gjatë punës së tyre.

Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me lëndë të vitit 2014, lëndë e cila i takon grupit të lëndëve të vjetra, **obligohet** gjyqtarja e çështjes që të filloj trajtimin dhe vendosjen e të gjitha këtyre lëndëve që i takojnë grupit të lëndëve të vjetra. Kjo sepse, pavarësisht kontestit, planet strategjike të KGJK-së por edhe Planet e Punës të Gjykatës synojnë zvogëlimin përkatësisht zgjidhjen e lëndëve që kanë një afat më të gjatë të pritjes. Respektivisht, rritjen e efikasitetit në trajtimin e lëndëve me karakter prioritar por edhe lëndëve në punë për një kohë të gjatë.

Andaj, nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/19/23, me datë 11.01.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë